



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2023

VENDIM
Nr.18, datë 27.06.2023

MBI
SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RAPORTIT PËRMBLEDHËS
TË BASHKIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË
“DELOITTE AUDIT ALBANIA” SH.P.K. DHE “DELOITTE ALBANIA” SH.P.K.
PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM TË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR PERIUdhËN 2021 - 2022

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “j”, të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 18, pika 1 dhe pika 4 të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 17 të Rregullores “Për kartën e auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin Qarkullues të Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 16, datë 30.04.2020, si dhe të nenit 18, pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Të miratojë raportin përmbledhës të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Deloitte Audit Albania” sh.p.k. dhe “Deloitte Albania” sh.p.k. për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për periudhën 2021 - 2022, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen njësitë organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

